



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.08-264

02.10.2024

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e RM-së“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e RMV-së“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit televiziv nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan, nr.yinë ark.08-3741/1 datë 12.09.2024, Deklaratën me nr UZP 3097/2024 datë 18.09.2024, nr.yinë ark.08-3741/3 datë 19.09.2024 nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit dhe Konkluzionin me nr.ark.02-3960/730.09.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 37-të mbajtur më 30.09.2024 miratoi:

Aktvendim

për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan.
2. Ky aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan, është posedues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-45 datë 07.09.2023, i cili transmeton program nëpërmjet operatori të rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel lokal në zonën e Komunës së Koçanit, Komunës së Vinicës dhe Komunës Çeshinë – Obleshë dhe Komunës së Zrnovcës, shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase.

Më datë 12.09.2024 Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan, drejtua Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) dorëzoi Njoftim (nr.yinë ark.08-3741/1 datë 12.09.2024), se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan, më datë 30.09.2024, do të ndërpresë transmetimin e programit televiziv. Me rastin e Njoftimit të cituar, Agjencia me datë 13.09.2024, me Shkresë, nr.yinë ark.08-3741/2, njoftoi transmetuesin në fjalë se në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzojë deklaratë të noterizuar nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit, në të cilën detyrimisht duhet të thuhet se transmetuesi Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan, ndërpreu me transmetim të programit televiziv, me paraqitjen e datës së saktë të ndërprerjes me transmetim të programit televiziv. Njëkohësisht, transmetuesi është njoftuar se me dorëzimin e deklaratës së kërkuar të noterizuar do të përmbushen kushtet ligjore që Agjencia të miraton Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të – Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan.

Më datë 19.09.2024, drejtuar Agjencisë nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan, është dorëzuar Deklaratë me nr. UZP 3097/2024 datë 18.09.2024 (e noterizuar), nr.yinë ark.08-3741/3 datë 19.09.2024 nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit – Toni

Ajtočki, se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan nga data 01.10.2024 ndërpreu së transmetuari programin televiziv.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, leja për transmetim televiziv ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimet e programit televiziv. Për përfundimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse leja i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi (2) të LSHMAAV).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV-së, si dhe deklaratën me shkrim të lartpërmendur nga themeluesi/pronari i vetëm i transmetuesit (e noterizuar), janë plotësuar kushtet ligjore për ndalimin e vlefshmërisë së lejes sipas fuqisë ligjore, pas së cilës Agjencia do të fshijë transmetuesin Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KANAL 8 SHPKNJP Koçan nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV-së, dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr.ark.01-3732/1 datë 29.07.2019, Njoftimin për ndërprerjen me transmetim të programit televiziv nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISION KANAL 8 SHPKNJP Koçan, nr.ynë ark.08-3741/1 datë 12.09.2024, Njoftimin nr. UZP 3097/2024 datë 18.09.2024, nr.ynë ark.08-3741/3 datë 19.09.2024 nga themeluesi/pronar i vetëm i transmetuesit dhe Konkluzioni me nr.ark.02-3960/7 datë 30.09.2024, është marrë vendim si në dispozitiv, i cili hyn në fuqi menjëherë.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.